



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr.56, datë 01.06.2020

**“PËR
EMËRTIMIN “MAKS VELO” TË KINEMASË TË NDODHUR NË LAPRAKË, NJËSIA
ADMINISTRATIVE NR. 11”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.7 shkronja “b”, nenit 25 pika 3, nenit 54 shkronja “ll” dhe nenit 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar, vendimit nr. 219, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave ”Për miratimin e listës përfundimtare të pjeshme (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të njësive Administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, të Qarkut të Tiranës”, të ndryshuar, si dhe në vijim të memos nr. 16661, datë 26.05.2020, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak i Tiranës,

VENDOSI:

- 1.** Emërtimin me emrin “Maks Velo” të Kinemasë me vendndodhje në Laprakë, Njësia Administrative nr.11, e cila kufizohet nga Rrugët “Pandi Dardha”, Rruga “Lord Bajroni” dhe “Tahir Sinani”.
- 2.** Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme për Marrëdhëniet me Publikun dhe Jashtë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit, për zbatimin e këtij vendimi.
- 3.** Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

K R Y E T A R

TONI GOGU

Konceptoi:
E.Demiraj